



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.431/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Rafet Haxhaj dhe Faton Ademi anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Anita Peci, duke vendosur përkitazi me ankesën e Ahmet Berishës, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Fushë Kosovë, për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 24.10.2017, mori këtë:

## V E N D I M

**HUDHET si e palejuar** ankesa ZL.Anr.431/2017 e datës 23.10.2017, e Ahmet Berishës, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Fushë Kosovë.

## A r s y e t i m

PZAP-i ka pranuar një ankesë me datën 23.10.2017 nga Ahmet Berisha, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Fushë Kosovë, me të cilën ka pretenduar se në Zgjedhjet Lokale të datës: 22.10.2017, ka mungesë të votave, si dhe ka kërkuar që të verifikohen fletëvotimet se a është përdorur lapsi kimik i njëjtë në fletëvotimin për subjektet dhe kandidatët.

Paneli, pasi që shqyrtoj paraprakisht lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

### **Ankesa është e pa lejuar**

Paneli pasi që shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës, nuk është lëshuar fare në vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljen e pretenduar, në ankesë përkitazi me mungesën e votave në vendvotimet e cekura, për faktin se shkeljet që ndërlidhen me rezultatin e votimit, nga shkelësi i supozuar, duhet të parashtrihen me rastin e shpalljes së rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procedurës. Në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk është marrë vendimi për shpalljen e rezultatit përfundimtar, andaj Paneli vendosi që ta hedh si të parakohshme ankesën e ankuesit. Hedhja e ankesës të ankuesit nuk e paragjykon çështjen dhe ankuesit nuk i mohohet e drejta që mbi këtë bazë, të paraqes ankesa tjera, pas shpalljes së rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Zl.Anr. 431/2017 me datën 24.10.2017.

**Kryesuesi i Paneli**  
**Zyhdi Haziri**



*Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-*